

REGJISTRI KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE - MAJ 2025

NR. RENDOR	DATA E KËRKESËS	OBJEKTI I KËRKESËS	DATA E PËRGJIGJES	PËRGJIGJE	MËNYRA E PËRFUNDIMIT TË KËRKESËS	TARIFA
1	02.05.2025	Kërkesë për informacion për aplikime apo leje të miratuara	09.05.2025	Në përgjigje të kërkesës Suaj.....ju bëjmë me dije si vijon; AZHT,në bazë të Ligjit Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit",i ndryshuar është autoriteti përgjegjës për zhvillimin e territorit si dhe kryen funksionet e sekretariatit teknik të KKTU.Gjithashtu, referuar po këtij ligji,në nenin 28 të tij,ndër të tjera përcaktohen përgjegjësitë e KKTU: <i>Pika1.KKTU-ja është autoriteti përgjegjës për vendimmarrjen për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi për llojet e zhvillimit komplekse, të përcaktuara në rregulloren e zhvillimit, dhe ato që lidhen me</i> <i>çështje, zona, objekte të rëndësisë kombëtare apo me investime strategjike për interesat e vendit,si dhe për vendimmarrjen për leje zhvillimi dhe ndërtimi për objektet brenda brezit të zhvillimeve të kontrolluara,sipas përkufizimit të ligjit për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare.KKTU-ja vendos miratimin e rregulloreve të veçanta për kushtet e zhvillimit për rastet në komeptencë të saj.</i> Për sa më lartë,referuar kërkesës Suaj,...pranë AZHT, pasi bëri verifikimet përkatëse në databazë, në pronën me nr.pasurie,nuk evidentoi asnjë aplikim apo vendimmarrje të KKTU. Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,mbetemi në dispozicion për çdo informacion të nevojshëm.	E plotë	Nuk ka

2	05.05.2025	Kërkim informacioni dhe vënie në dispozicion të kopjeve të dokumentave në lidhje.....	09.05.2025	Në përgjigje të shkresës Suaj,..... ju sqarojmë se; Sikusre jeni në dijeni.....Vendimi i sipërcituar është konfirmuar dhe publikuar në faqen web www.azht.gov.al, së bashku me dokumentacionin i cili e shoqëron. Gjithashtu, në lidhje me këtë vendimarrje AZHT pas plotësimit të dokumnetacionit tekniko-ligjor dhe pagesës së takss së ndikimit në infrastrukturë për llogari të.... ka pajisur... me Dokumnetin e Lejes së Ndërtimit..... Në vijim të kërkesave për dokumnetacion në lidhje me aplikimin sipërcituar, ju bëjmë me dije se AZHT nuk mund t'ju vendosi në dispozicion dokumentacionin teknik të kërkuar nga ana juaj, pasi referuar Nenit 17 "Kufizime",pika 1, shkronja "c";,të Ligjit Nr.119/20214 :Për të drejtën e informimit",citohet se e drejta për informim kufizohet kur dëmton të drejtën e autorit.Mbështetur në Nenin 8 "Veprat",pika 1, shkronjat"e" dhe "g",të Ligjit Nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to",veprat që janë objekt i mbrojtjes së të drejtës së autorit janë: <i>e) krijimet arkitekturore, që përfshijnë vizatimet, planet, skicat në shkallë të zvogëluar dhe krijimet grafike në projektet arkitekturore;</i> <i>g) krijimet tredimensionale, ilustrimet, listat, hartat dhe vizatimet në fushën e topografisë, gjeografisë dhe shkencës në përgjithësi;</i> Gjithashtu në vijim të përgjigjes së shkresës suaj ju bëjmë me dije se referuar Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,as dokumentacioni i pronësisë,nuk mund t'ju vendoset në dispozicion nga ana jonë,pasi përmbajnë të dhëna personale. Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,mbetemi në dispozicion për çdo informacion të nevojshëm.	E plotë	Nuk ka
3	06.05.2025	Kthim përgjigje për shkresën....	06.05.2025	Në përgjigje të kërkesës Suaj,.....ju bëjmë me dije si vijon; AZHT,në bazë të Ligjit Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit",i ndryshuar është autoriteti përgjegjës për zhvillimin e territorit si dhe kryen funksionet e sekretariatit teknik të KKTU.Gjithashtu,referuar po këtij ligji,në nenin 28 të tij,ndër të tjera përcaktohen përgjegjësitë e KKTU; <i>Pika1. KKTU-ja është autoriteti përgjegjës për vendimarrjen për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi për llojet e zhvillimit komplekse, të përcaktuara në rregulloren e zhvillimit, dhe ato që lidhen me çështje, zona, objekte të rëndësisë kombëtare apo me investime strategjike për interesat e vendit,si dhe për vendimarrjen për leje zhvillimi dhe ndërtimi për objektet brenda brezit të zhvillimeve të kontrolluara,sipas përkufizimit të ligjit për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare.KKTU-ja vendos miratimin e rregulloreve të veçanta për kushtet e zhvillimit për rastet në komeptencë të saj.</i> Për sa më lartë,referuar kërkesës Suaj,...pranë AZHT, pasi bëri verifikimet përkatëse në databazë, në pronën me nr.pasurie,nuk evidentoi asnjë aplikim apo vendimarrje të KKTU.	E plotë	Nuk ka

4	06.05.2025	Shënim : kërkesë pa objekt	07.05.2025	Në përgjigje të kërkesës Suaj, drejtuar nëpërmjet adresës elektronike, lutemi referojuni bazës ligjore bashkëlidhur për informacionin e saktë ligjor të një leje zhvillimi dhe ndërtimi, dokumentat, afatet, palët e përfshira në proces (zhvilluesi, projektuesë të licencuar dhe autoritetet vendimmarrëse). dhe procesin e hartimit të dokumentacionit të kërkuar për aplikim në portalin elektronik të lejeve "E-Leje".	E plotë	Nuk ka
5	08.05.2025	Kërkesë vënie në dispozicion të kopjes së Lejes së Ndërtimit.....	12.05.2025	Në përgjigje të shkresës Suaj...ju sqarojmë se: Sikurse jeni në dijeni, pranë AZHT, si Sekretariati Teknik i KKTU, është depozituar nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve aplikimi.... Në vijim, në përputhje me Ligjin Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, KKT në mbledhjen.....në përputhje me Ligjin Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Në vijim, sqarojmë se referuar hartës së planvendosjes së strukturave e cila është pjesë përbërëse e Vendimit..., rezultoi se pasuritë të cilat preken nga gjurma e këtij projekt-propozimi janë pasuritë..... Për sa më sipër, në lidhje me pretendimin tuaj, nga verifikimi..pranë institucionit tonë, rezultoi se pasuria ku ju jeni bashkëpronarë, konkretisht pasuria..., është pasuri kufitare me pasuritë të cilat preken nga gjurma e projekt-propozimit dhe si e tillë nuk përfshihet në zhvillimin objekt i kësaj shkrese. Bashkëlidhur gjeni:....	E plotë	Nuk ka
6	14.05.2025	Kërkesë	22.05.2025	Në përgjigje të shkresës Suaj..., ju bëjmë me dije se: Nga verifikimi ...pranë institucionit tonë, rezultoi se mbi pasuritë objekt i shkresës suaj, pranë AZHT nëpërmjet sistemit elektronik e-lege, është protokolluar aplikimi..... Në lidhje me aplikimin sipërcituar, KKTU në mbledhjen....ka vendosur..., në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, vendim i cili është ende në proces zbardhje. Për sa më sipër, në përfundim të procesit të zbardhjes, Vendimin..., do t'a gjeni të publikuar së bashku me dokumentacionin që e shoqëron, në faqen zyrtare web të AZHT www.azht.gov.al , në Rubrikën "Vendime KKT".	E plotë	Nuk ka

7	19.05.2025	Leje Ndërtimi	19.05.2025	Në përgjigje të kërkesës Suaj, drejtuar nëpërmjet adresës elektronike, lutemi referojuni bazës ligjore bashkëlidhur ku gjendet informacioni i plotë dhe i saktë ligjor për aplikim për leje zhvillimi dhe ndërtimi, etj.. Në këtë dokument mund të informoheni mbi dokumentat e nevojshëm për aplikim, afatet e procesit nga momenti i aplikimit deri në finalizimin e tij, palët e përfshira në proces (zhvilluesi, projektuesë të licencuar dhe autoritetet vendimmarrëse) si dhe procesin e hartimit të dokumentacionit të kërkuar për aplikim në portalin elektronik të vetëm qeveritar "e-albania", në sistemin elektronik të lejeve të ndërtimit "E-Leje". Gjithashtu ju informojmë se për informacion dhe sqarim më të saktë, bashkë me dokumentat që zotëroni, mund të paraqiteni pranë sporteleve të informacionit të bashkisë përkatëse.	E plotë	Nuk ka
8	19.05.2025	Kërkesë-Ankesë	26.05.2025	Shënim:Në zbatim të Nenit 24, pika 1 të Kodit të Procedurave Administrative ku përcaktohet se: “<i>Kur një organ publik merr një kërkesë,për një çështje që e vlerëson jashtë kompetencës së vet,ia përcjell kërkesën menjëherë,organit publik kompetent dhe njofton kërkuesin për këtë</i>”, kërkesa është përcjell në organin publik kompetent,ku dhe kërkuesi është vendosur në dijeni për këtë.	E plotë	Nuk ka
9	19.05.2025	Kërkesë	27.05.2025	Në përgjigje të shkresës Suaj,..... sqarojmë se: Sikurse jeni në dijeni, pranë AZHT, është depozituar nëpërmjet sistemit elektronik e-leje aplikimi..... Gjithashtu sqarojmë se Leja e Zhvillimit është një dokument në të cilën përcaktohen vetëm kushtet e zhvillimit për një parcelë/pronë të caktuar,konkretisht <i>përdorimi i tokës, intensiteti i ndërtimit, koeficienti i shfrytëzimit të tokës,distanca etj.</i> ,dhe nuk nënkupton që në bazë të këtij dokumneti subjekti zhvillues të mund të fillojë punimet për ndërtim. Lidhur me kërkesën Tuaj, nëse subjekti zhvillues është pajisur me leje ndërtimi,ju bëjmë me dije se, K KU, në mbledhjen.....,në përputhje me Ligjin Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit",i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij i cili është në proces konfirmimi. Për sa më sipër,ju njoftojmë se sapo të përfundojë procesi i konfirmimit të Vendimit të KKTU...,këto dokumente do të publikohen (në mënyrë që të jenë të aksesueshme për të gjithë subjektet,ashtu sikurse të gjithë Vendimet e tjerë të KKT), në adresën zyrtare të Agjencisë Zhvillimit Të Territorit: http://www.azht.gov.al,në rubrikën "Vendime KKT".	E plotë	Nuk ka

10	21.05.2025	Kërkesë për informacion mbi procedurat e pajisjes me leje ndërtimi në zonat bregdetare	21.05.2025	Në përgjigje të kërkesës Suaj, drejtuar nëpërmjet adresës elektronike, lutemi referojuni bazës ligjore bashkëlidhur ku gjendet informacioni i plotë dhe i saktë ligjor për aplikim për leje zhvillimi dhe ndërtimi, etj.. Në këtë dokument mund të informoheni mbi dokumentat e nevojshëm për aplikim, afatet e procesit nga momenti i aplikimit deri në finalizimin e tij, palët e përfshira në proces (zhvilluesi,projektuesë të licencuar dhe autoritetet vendimmarrëse) si dhe procesin e hartimit të dokumentacionit të kërkuar për aplikim në portalin elektronik të vetëm qeveritar "e-albania", në sistemin elektronik të lejeve të ndërtimit "E-Leje".	E plotë	Nuk ka
11	23.05.2025	Ankesë	06.05.2025	Shënim: Në zbatim të Nenit 24, pika 1 të Kodit të Procedurave Administrative ku përcaktohet se: <i>“Kur një organ publik merr një kërkesë,për një çështje që e vlerëson jashtë kompetencës së vet,ia përcjell kërkesën menjëherë,organit publik kompetent dhe njofton kërkuesin për këtë”</i> , kërkesa është përcjell në organin publik kompetent,ku dhe kërkuesi është vendosur në dijeni për këtë.	E plotë	Nuk ka
12	26.05.2025	Ankesë	23.06.2025	Në përgjigje të ankesës Suaj...Ju bëjmë me dije,si më poshtë vijon; AZHT, e cila aktualisht funksionon si Sekretariat Teknik i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, në mbështetje të Vendimit Nr. 725, datë 02.09.2015 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, ka kompetencë <i>pranimin, përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionit që shqyrtohet dhe miratohet në mbledhjet e KKTU-së</i> Ndërkohë,përsa i përket pretendimeve tuaja si lidhur me distancat,Ju bëjmë me dije se KKTU ështëorgan kolegjal,që funksionon pranë Këshillit të Ministrave dhe kryesohet nga Kryeministri.Vendimmarrja e sipërcituar është ndërmarrë pas një vlerësimi të përbashkët të anëtarëve të këshillit në zbatim të Ligjit Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit",i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Për sa më sipër,lidhur me pretendimin tuaj për distancat jusqarojmë se,referuar Ligjit Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit",i ndryshuar,në Nenin 28,Përgjegjësitë e KKTU në fushën e zhvillimit të territorit,pika 3,përcaktohet se: <i>"KKTU-ja vendos miratimin e rregulloreve të veçanta për kushtet e zhvillimit për rastet në kompetencë të saj"</i> .	E plotë	Nuk ka
13	27.05.2025	Kërkohet informacion nëse ka aplikim për leje zhvillimore për pasuritë....	23.06.2025	Në përgjigje të shkresës Suaj..ju sqarojmë se: Pranë AZHT,si Sekretariat Teknik i KKTU është depozituar nëpërmjet sistemit elektronik e-leje aplikimi... Për sa më sipër,në lidhje me pretendimin tuaj,nga verifikimi..pranë institucionit tonë rezultoi se pasuritë..... Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,mbetemi në dispozicion për çdo informacion të nevojshëm.	E plotë	Nuk ka

14	28.05.2025	Kërkesë për informacion			Në proces	Nuk ka
15	29.03.2025	Kërkesë për vënie në dispozicion të dokumentacionit	02.06.2025	Në përgjigje të kërkesës Suaj...,lutemi gjeni bashkëlidhur: Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,mbetemi në dispozicion për çdo informacion të nevojshëm.	E plotë	Nuk ka
16	30.05.2025	<i>Shënim</i> : kërkesë pa objekt			Në proces	Nuk ka